



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1178/4 prot.,

Datë 09.06.2022

V E N D I M

Nr. 541/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1178 prot., 02.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2249, për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-27322-05-04-2022, me objekt: “*Loti 1 Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë-Durrës*”, me fond limit 3.405.192 (Tre milion e katërqind e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “TOWER” SHPK
Adresa: Njësia bashkiake nr. 2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla2, kati 3, apartamenti 9, nr. Pasurie 6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A
Adresa: Rruga Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi Postar 1027.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.05.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-27322-05-04-2022, me objekt: “**Loti I Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë-Durrës”**”, me fond limit 3.405.192 (Tre milion e katërqind e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

II.2. Në datën 16.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.05.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- E.B.S. SHPK	I Skualifikuar	2,820,000
- “A & E ENGINEERING” SHPK	I Kualifikuar	2,892,912
- BOE“HYDRO-ENG CONSULTING” SHPK &”PCS” SHPK	I Kualifikuar	2,960,923
- “INSTITUTI DEKLIADA - ALB” SHPK	I Kualifikuar	2,963,013.43
- “BN PROJECT” SHPK	I Kualifikuar	2,963,193
- “M.A.K Studio” SHPK	I Kualifikuar	2,963,326.41
- “G & L CONSTRUCTION” SHPK	I Kualifikuar	2,945,491
- “CIVIL CONS” SHPK	I Kualifikuar	2,963,458.54
- “PROJECT DALUZ 2019” SHPK	I Kualifikuar	2,963,536
- “TOWER” SHPK	I Kualifikuar	2,963,536
- “NOVATECH STUDIO” SHPK	I Kualifikuar	2,963,536.09
- MAGNA CHARTA” SHPK	I Kualifikuar	2,966,847
- “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN"” SHPK	I Kualifikuar	3,030,321
- “INFRATECH” SHPK	I Kualifikuar	3,064,620
- “GJEOKONSULT & CO” SHPK	I Kualifikuar	3,212,388.18
- “Taulant” SHPK	I Skualifikuar	pa ofertë
- “Erald-G” SHPK	I Skualifikuar	pa ofertë
- “HE&SK 11” SHPK	I Skualifikuar	pa ofertë

II.4. Në datën 27.05.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e **Njoftim-Fituesit** në sistemin e prokurimeve elektronike dhe është publikuar njoftimi i fituesit në Buletinin Nr. 69 datë 30.05.2022, prej të cilit rezulton fitues operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK.

II.5. Në datën 02.06.2022, operatori ekonomik ankimues “TOWER” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe në sistemin e ankesave elektronike pranë KPP-së dhe autoritetit kontraktor, me numër ankimi elektronik A/2022/2249. Ankimesi në ankesën drejtuar Komisionit dhe autoritetit kontraktor pretendon si më poshtë:

Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë ofertat duke marrë parasysh Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 i Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 i Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudime.

Për shërbimet e parashikuara në vendimin e sipërcituar, APP rekomandon që, krahas përlllogaritjes së fondit limit (i cili përlllogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar), bëhet përlllogaritja e vlerës minimale të lejuar (e cila përlllogaritet nisur nga përqindja minimale e lejuar), në varësi të kategorisë dhe grupit tarifor, ku bën pjesë objekti i prokurimit.

Nga vlerësimet, vëmë re se Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar oferta të cilat janë nën vlerën minimale (referuar VKM 354).

Kur ekziston një bazë ligjore e posaçme që rregullon vlerat minimale, çdo autoritet është i detyruar ta ketë parasysh gjatë vlerësimit të ofertave dhe ta zbatojë atë me përpikëri.

Në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim.

Për procedurën konkrete:

Fondi limit (i cili përllogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar) është 3,405,192 (Tre milion e katërqind e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa t.v.sh.. Në S.P.E. gjejmë procedurën përkatëse të zbatimit : REF-25396-04-15-2022, me objekt Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë -Durrës , me fond limit 261 334 752 lekë pa TVSH.

Për objektin Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë -Durrës REF-25396-04-15-2022 bëjmë analizën e mëposhtme:

Në bazë të VKM Nr.354, datë 11/05/2016 për Miratimin e Manualit të Tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim , përcaktojmë tarifat e planifikuara për mbikëqyrësin e punimeve. Vlera e preventivit pa TVSH për këtë objekt është: 261 334 752 lekë.

Ky objekt përfshihet në Kreu III - Seksioni III-Vepra Inxhinierike në Grupin III Tarifor. Sipas VKM Nr.354, Neni 36 fazat e projektimit të veprave inxhinierike, përqindja e tarifave është si më poshtë:

Faza e VIII-të Mbikëqyrja 20.00%

Për kosto të llogaritshme me vlerë: 261 334 752 lekë.

Sipas VKM nr.354, Neni 38 Tabela e tarifave, për shërbimet, në lidhje me punimet e veprave inxhinierike.

Vërejmë se vlera jonë 261 334 752 lekë, për grupin tarifor 3, gjendet midis dy vlerave me koeficientet përkatës:

Vlerës 250 000 000 me koeficient max: 6.64% dhe koef. Min. 5.79%

Vlerës 300 000 000 me koeficient max: 6.09% dhe koef. Min. 5.26%

Për vlerën tone 261 334 752, duke përdorur interpolimin linear, arrijmë në përfundim që Koeficienti maksimal është 6.515%

Koeficienti minimal është 5.670%

Pra vlera totale e llogaritjes do te jete:

Max: 261 334 752 lekë x 6.515%= 17 025 959

Min: 261 334 752 lekë x 10.491% = 14 817 680

Vlerat maksimale të tarifave do të jenë:

Mbikëqyrja 17 025 959 lekë x 20% = 3 405 192 lekë

Kjo vlerë përputhet me fondin limit të procedurës (i cili përlllogaritet nisur nga përqindja maksimale e lejuar), çka tregon se kemi përdorur kategorinë dhe grupin tarifor të duhur.

Vlerat minimale të tarifave do të jenë:

Mbikëqyrja 14 817 680 lekë x 20% = 2 963 536 lekë

Nga lista e vlerësimeve, vëmë re se Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar oferta nën Vlerën minimale, (referuar VKM 354), p.sh. duke filluar nga oferta në vlerën 2 963 458.54, deri në vlerën 2 892 912 lekë pa TVSh.

Nga sa më sipër kuptojmë, që:

1-Autoriteti kontraktor ka bërë një gabim njerëzor në përlllogaritjen e fondit limit dhe/ose vlerës minimale. Nëse gjykohet nga KPP që kemi të bëjmë me këtë rast, atëherë kërkojmë rivlerësim apo anulimin e procedurës dhe rishpalljen e saj me vlerat e korrigjuara, si dhe në dokumentet e tenderit operatorët ekonomikë të bëhen me dije mbi kategorinë dhe grupin tarifor të përdorur në respektim të Rekomandimit të APP-së nr.5585 datë 25.07.2017.

2- Autoriteti Kontraktor ka bërë në mënyrë të njëanshme përlllogaritjen e vlerës minimale në kundërshtim me përmbajtjen e VKM 354, me qëllimin për të favorizuar një OE të caktuar ose për të dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorët e tjerë ekonomikë.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të publikojë procesverbalin e llogaritjes së vlerës minimale dhe maksimale, duke përcaktuar qartë kategorinë dhe grupin tarifor të përdorur në llogaritje, me qëllim që të sigurohemi që si AK, si OE pjesëmarrës, kanë të njëjtin kuptim mbi vlerën minimale.

Kërkojmë Ekspert të pavarur për përlllogaritjen e tarifave minimale dhe maksimale për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim, në përputhje me VKM nr.354 datë 11.05.2016. Objekti i ekspertizës të jetë llogaritja e fondit limit dhe vlerës minimale të procedurës objekt ankimimi.

Kjo gjë do t'i shërbente të gjithë OE pjesëmarrës për këtë procedurë si dhe për procedurat e tjera të ngjashme në të ardhmen, duke shmangur keqkuptime dhe ankime të panevojshme.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1178/2022/2 prot., datë 03.06.2022, kriterin për të cilin operatori ekonomik ankimues “TOWER” ShPK pretendon, se nuk përmbushet/n nga operatorë ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

II.7. Me shkresën nr.TM0337_L1/02 prot., datë 04.06.2022 protokolluar me tonën me nr. 1178/3 prot., datë 06.06.2022 operatori ekonomik “TOWER” SHPK ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga ankesa për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “TOWER” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në datën 02.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2249, në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-27322-05-04-2022, me objekt: *“Loti I Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë-Durrës”, me fond limit 3.405.192 (Tre milion e katërqind e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Në nenin 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet: *“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.”*

III.1.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, për sa kohë operatori ekonomik ankimues ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga ankimi, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik nuk do të marrë në shqyrtim ankesën nr. 1178 prot., 02.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2249, për

procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative objekt-ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-27322-05-04-2022, me objekt: “**Loti 1 Mbikëqyrje e punimeve për objektin “Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën e Autostradës Tiranë-Durrës ”**, me fond limit 3.405.192 (Tre milion e katërqind e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TOWER” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri

